

E DIEL  
4 Qershor  
2017



e-mail: milosao2005@yahoo.com



Salvador Dalí, "Atomica" 1948

Debati

# A DUHET BRAKTISUR STANDARDI I 1972?!

NGA LEKË TASI\*

Zvarritja e zgjidhjes së problemeve, karakteristike e periudhës postdiktatoriale, i dha dorë Standardit të 1972 të zërë vend më masivisht nga sa i druheshin ata që e duan Shqipërinë të tërë pasurinë e saj, dhe jo të rëgjuar shumë a pak në një degë të saj. Të shkruarit sipas traditës së vet përqendrohet ende relativisht në pak pena geqe, kurse të folurit reziston por vetëm tek të pashkolluarit ose në momente të pavetdijshme të intelektualëve të konformuar. Kjo zbrapsje e dialektit më të pasur me folklor epik e letërsi të hershme, është një fatkeqësi më thelbësore se emigracioni masiv, i cili e ka edhe një anë pozitive, ndikimin direkt ose indirekt mbi gjendjen e vendit, me përmirsimin sëlargu falë arsimit cilësor, me ndihmën buxheteve familjare, dhe ca

më mirë me rikthim e investim në vendlindje. Kurse harresa e të folurit verior prej ndikimit të shkollës siç e konstatojmë përdit nëpër intervista, po rrezikon të bahet një proces i rëndomt, duke shtuar përdit rrezikun e një varfërimi të pakthyeshëm. Çështja në tërësi ka të bëjë jo vetëm me imponimin mbi shumicën (3/4 të shqiptarëve) të një modeli që nuk është i veti, çështja qëndron tek humbja e pariparueshme e bukurisë së shqipërisë, e cila pa asnjë dyshim banonte në Veri: morfologji e lokucione lakonike, fonetikë muzikale (me kontraste zanore/bashktingullore), veti këto që nëse merren masa për tu rruajt, sjellin dobi të shumta, të cilat do t'i trajtojmë më poshtë.

**GOJA E POPULLIT REAGON.**

**DUHET MBESHTEJE.** Le ta shohim çështjen nga një pozicion tjetër. Standardi, pavarësisht nga qëllimi i fshehur politik për ta eklipsuar dialektin geg në kuadër të luftës së klasave dhe më gjerë, pati edhe një efekt pozitiv, atë të njohjes të toskërishtes në Veri. Procesi i përkundërt siç porositën antarët më largpamës të komisionit 72 (pajisje e gjuhës letrare me fjalor e konstrukte edhe veriore) u zbatua shumë pak. Megjithatë veprimi i vetvetishëm në gojë e popullit e ka luejt një farë roli: pranë të shkruarit konform standartit si inercie e censurës edhe në liri, populli i ka përzije mjaft dy të folmet jo vetëm në Veri siç thamë, por edhe në Jug (kjo ka rëndësi), falë një kontakti më të dendur se në të kaluarën mes popullsisë. Kjo përzjerje në

praktikën e përditshme i shqetson *standartistët* më striktë, por është kjo që do ta sjellë integrimin e të gjitha resurseve gjuhësore sot në zbehje, nëse huazimi reciprok nxitet zyrtarisht sot e tutje. Parakusht i domosdoshëm të kalohet nga shkruarit gati ilegale geqe tek a) dekretimi i bashkjetesës të dy lloj mënyrash shkrimi në letërsi, siç ndodhte deri në 1972, me tipar të ri guximin që autorët e dy degëve të huazohen reciprokisht, dhe b) rikthimi i gjuhës zyrtare të para 1945, një gegnishte e moderuar sikundër cilsohej dikur. Këta hapa njëherazi pasurues dhe unifikues, do të rijetësonin *paskajoren* dhe *rrokjet e gjata* me anë theksit. Përfshirja e tyre në programet shkollërore dhe në

fjalorë, sigurisht ndesh në rezistencë, mbasi çdo ndryshim i statusit quhet mbrohet me xhelozë në çdo fushë; kokëfortsia konservative e Akademisë fsheh një ndjeshmëri nevralgjike që ka të bëjë me interesat përtej vogëlimave si reforma gjuhësore; episodi i përkujtimin të M. Camaj, i përshkruar nga Primo Shllaku e dëshmon. Por shumkush është i bindur singërisht që efekti i standartit gjat 50 e ca vjetve ka qënë dhe mbetet pozitiv. Sido që të argumentohet kjo, rreziku i varfërimit të shqipërisë po bëhet prorë ma i mprehtë; alarmin e kanë dhanë prej vitesh një numur intelektualësh me shkrime e aktivitete të organizuara në drejtim të ndaljes së tij.



Vijon në faqen 15

**Në këtë numër: Dasa Drndic në shqip me "Sonnenschein" (pjesëz); Krijimtari nga Anton Papeleka; Lekë Tasi, një argument për standardin; Meri Lalaj për Berberin...**

A

ARGUMENT

NGA LEKË TASI

Vijon nga faqja 1

Mbas ligjsimit të paska jores dhe zanoreve të gjata, dhe rivendosjes së gëgnishtes gjuhë zyrtare, siç ishte para diktaturës, do të duhej një platformë edhe ma e gjanë me munda të reja integrimi të njëkohshëm të resurseve dialektale. Fjala *njëkohshëm* është senjali kyç i një pasurimi që do të përdorte baraz të gjitha llojet e pjesores (*uem-ue-(u)-uar-ose bamun, -bamë, -bërë, -ba, -bë*, dhe po ashtu alternimin e *n* me *r* - *sh-tetnor-shtetëror*; duke i nda të parat si zyrtare, por pa përfshirur të dytat për kërkesa të veçanta stili, madje edhe *zëror kundrejt zanor-zanore* që dominon edhe në standart). Pra ndërsa gjuha e shkresave do të jetë gëgnishtë me një farë kodifikimi, ajo letrare do të ketë një larmi që do t'i shërbejë sipas shkruarit dhe rastit herë stilit herë muzikalitetit, herë të dyave njëherësh. Një shembull: *mbretëria e qiejve* (soleme), *mbretëria e ujrave/gjelbërisë/blerimit* (onomatopei). Këtë zgjerim mjtesh në gjuhën letrare e mundson praktika e sotme që po e zbeh ndjeshmërinë e mëparshme ndaj përzjerjeve dialektore; ndihet ky proces në çdo nivel (paskajorja ka hyrë dhe ndër jugorë - *me shku, tue e nisur*. Te shkrimtarët e vjetër kemi pasë *uom-uam*, ndërsa sot gjejm në Veri edhe -*ua*). Kur thamë që bukuria e shqipes banon në Veri kemi parasysh kryesisht epërsin e *as-gege mbi ë-në* toske. Dëndësia në një faqe libri të këtyre rasteve e përligj këtë pohim. "Ti ke pas kenë një zojë e randë/burrat e dheut të quejshin nanë". I le të provojm ta kthejm këtë varg në toskërisht, dhe do ta kemi demonstruar këtë epërsi. Tipari tjetër epror i gëgnishtë është shkurtësia (*shkoj n'kam-b-vete në këmbë*, dy rrokje kundrejt pesë). Nga ana tjetër me larmi të mjeteve nënkuptojm si bashkëgenien ashtu dhe profilizimin e dy formave, pra një hap më përpara drejt njësimi se deri në 1972: integrim në afat të gjatë të dy dialekteve e jo zëvendsim të njërit nga tjetri. Zyrtarizimi në 1972 i vetëm trajtës -*uar* linte jasht variantet e lashta dhe i hiqte gjuhës letrare resurse të pasura poetike (rimat), kurse prozës nuanca historike e muzikalitet. Me kriterin gjithpërfshirës që përmendëm si të duhur në letërsi, dhe me ripohimin e gëgnishtës së Elbasanit si normativë zyrtare (duke i shtuar theksin hundor që ajo e ka bjerrë), do të ruhen edhe do trajta toske me një profilizim kuptimor të tyre sipas asaj që evokojn. Ato geqe kanë më solemnitet, *Lum për ty o madhi Zot, se s'jem kan' e na ke ba*, por ka raste që përmbysin këtë kriter pro-geg, shembull: *mësues* do të jetë thjesht mësimdhënës,

Megjithëse jo në materien e vet, Lekë Tasi argumenton në këtë shkrim pse duhet braktisur standardi i vitit 1972. Duhet të vendosë shija e rafinuar e poetëve dhe prozatorëve, jo ajo e gjuhëtarëve. Dhe kriteri i padiskutueshëm është shkurtësia. Atë na e siguron dialekti verior thotë i bindur autori. Shkrimi është lënë në originalin që ka sjellë autori, me dëshirën e tij për ta përcjellë sa më të qartë idenë dhe dëshirën e tij...



## ARSYET PSE DUHET BRAKTISUR STANDARDI I 1972

kurse *Mësonjës* -udhëheqës shpirtëror. Me një ndjeshmëri të hollë ky profilizim do të pikasë sugjestionin që kemi prej tingëllimit, vjetëris o rrallësis së trajtave për ti dhënë nuancën kuptimore; kështu prapashtesa — *onjës* mund të jetë në tërësi e një stili të lartë: *ekzistonjës* - filosofike, kurse *ekzistues* e natyrës statistike; *çponjës*-psikologjike (metaforikisht), kurse *çpuës*-efekt mekanik, *hetonjës*-gjuqësore, kurse *hetues*-psikologjike (*me sy hetues*). Të tilla profilizime të trajtave që do të rekuperonin të pasurinë morfologjike veri-jug mund t'i oporojë me kohë gjuha letrare gjat përdorimit, por edhe nën kompetencën e një komisioni krijuesish e gjuhëtarësh me ndjeshmëri estetike (e jo ndjekës striktë të rregullit). Poetët edhe në të kaluarën nuk kanë ngurruar të zgjedhin fjalë në dialekte të ndryshme nga i veti. Janë rrallësia, përjashtimi, licenca që i japin frymë letërsisë, pra dhe që krijojnë nuancat, aq sa të fitojn të drejtë për të hyrë në fjalor.

### NORMA - NJE TERM ME I GJERE SE DERI SOT.

Do të ishte mirë që vet koncepti *normë* të nënkuptonte një përzgjedhje në një fondi përkatës të ndryshme, ashtu si vet standarti ka lënë në raste të veçanta liri shkruarit të zgjedhë mes dy o tre varianteve (shembull *patur-pasur-pasë*). I tërë ky proces

s'mund të kuptohet pa një përforsim të profilit filologjik të lëndës së gjuhë-letërsisë në shkollë, dhe sigurisht shtimin e numrit të orëve në programin javor. Kjo do të ishte baza, mbasi ngre interesin për gjuhën tek moshat e reja dhe shton lëndën leksikore prej nga do të dalin trajtat me vështirësi të diferencuara. Kur theksojm



### Të vihet në program pasuria e Kristoforidhit

Të vihet në program sëpari përvehtësimi nga gjenerata e re e pasurisë gjuhësore që gjejm tek shkrimtarët e vjetër e të cituar përmblendta nga Kristoforidhi, e poezis popullore (Eposi i Veriut etj.), asaj Jugore, Arbreshë, dhe e kontributit të krijuesve të mëvonshëm, sigurisht mbasi një qëmtimi të rreptë për të nxjerrë vlerat letrare, e pa donjë detyrim të madh kundrejt autorëve me emër por që s'paraqesin vlera artistike. Duke qënë geg vetë por në kufi të Toskëris, Kristoforidhi me dy Dhjata, sëpari gëgnishtë, pastaj toskërishtë, dhe me Fjalorin, del babai i gjuhës letrare moderne. Kontributi i tij si autor mbeti panjohur për publikun e sotm (?). Duke cituar në Fjalor dialektet dhe autorët e vjetër, ai sikur na jep qysh atëhere orientimin që theksuam më lart, të një harmonizimi-integrimi me kohë të dy dialekteve.

pothuaj në Tiranë nuk thot më *shoh*, por *shof*, *shife*, ashtu dhe jo *ue*, por *-u*, *-y* (kam shku, u kry). Por pranëgenia *njohje-njofje-njohuri-njofturni* - nuk do shkaktojë bezdi. Do të ishte shumë e dobishme të hartohet rast për rast ky profilizim sipas vëzhgimeve, veçan në zonën metropolitane që jep tonin, atë qytetse dhe suburbane të kryeqytetit, profilizim që do të na jepte një tablo të prirjeve që prodhojnë larmi vështrimesh për fjalë të cilat, kur shkruhen e fliten siç figurojnë në fjalor, ngjajn përher e më të vjetëruara, pra nuk preferohen në një letërsi që kërkon pulsin e jetës. Të pasurit e një gjuhe të lartë dhe e një bisedore, të dyja të ligjësuara, u jep dorë gjuhëve të zhvilluara për një shprehje letrare shumë të pasur. Brënda këtij procesi çdo tkurje (veti geqe) është pozitive, si kalimi *fëmijëri-fëmini-fimi*, ose ndajfoljet e pashqitueshme e për tu fshirë nga fjalori - *rastësisht* e *ngushtësisht*, *qartësisht*, për të ripëruar në jetë në vend të së parës njërrrokshen *gan ose gand*, dhe heqjen e mbaresës absurde *-sisht* për të tjerat, duke e kthyer në thjeshtë: *ngusht* (shembull: *le ta marrim ngusht teknikisht, kuptimi del qart, qartazi e konceptuar*). Reduktimi ka funksion eufonik dhe prova më e dukshme është a (me theks hundor në vend të *asht*, për të shmangë *dy sh* rresht (*asht shtrënjt*, që afërmendsh bëhet: *a shtrënjt*) po edhe ë, siç e do kënga: *s'ë për mua e për ty/po për gjithë Shqipëri*. Po ashtu, kujdesi për një shprehje të rjedhshme do të hyjë në mësim si disiplinë me tekste, për të mos përsëritur b.f. një bashktingëllore në fjalën pasuese: *gjer te dera; deri te gjuri*.

### DOBIT QE RJEDHIN .

Tkurja në pak rrokje e frazës, siç e ka gëgnishtëja, i vlen poezisë, filmi, teatri. Ka gjuhë të privileguara që e kanë në natyrë reduktimin (anglishtja), dhe kjo veti u shërben shumë në kinema o teatër; ku kërkohet koncentrim; ndërsa të tjera, (spanishtja, italishtja, greqishtja etj.) duke qënë shumrrokshe, u duhet të shtojnë shpejtësinë e shqiptimit të rrokjeve, e kjo i kushton dramaticitetit, që kërkon fjalë të ketë peshe; pra replika të shkurtta.

Vijm tek ndryshimi tjetër i dy dialekteve: Përdorimi i **n** apo **r** në mbarsa, një vështirësi që duhet zgjidhur kur tashmë ka hyrë gjithandë e dyta (*Shqipëri* e jo *Shqipni*). Kjo ka të bëjë me eufoninë, dhe sigurisht është **n** që fiton, si domos kur në rrokjen pasuese kemi një **r**; ndaj duhet *shtetnor*, *fminor*, e jo *shtetëror*, *fëmijëror*, *mullini* e jo *mulliri* (ngaçë shumsi bën *mullinjt*). Gëgnishtëja alternon si rregull **n** me **r**, kurse Toskërishtja i kthen të dyja në **r**, ndaj ka dalë nevoja të adoptohet *zanore* e jo *zërore* si ma eufonike. Por

ekzistenca e dy o tre varianteve krijon larminë, në këtë rast larmi muzikale, që mund të kthehen herë-herë në nuanca kuptimore. Nuk na duhet koherenca dialektore por loja estetike bashktingullore-zanore, pra del më e pëlqyer të kemi përzjerje kur kriteri eufonik krijon brënda fjalës lehtësi tingëllimi me fjalë përkatësie të ndryshme dialektore. Kështu fondi i gjuhës duhet trajtuar si një serrë me filiza të disponueshme prej çdo këndi të territorit. Serrë ku kryesisht poeti/shkrimtari zgjedh e propozon, dhe autoriteti gjuhësor me sens kritik mbi të gjitha pro shqiptimit të bukur konfirmim ose refuzon mbas një kohe të mjaftueshme për të provuar suksesin e tyre në masën e kulturuar. Tek eufonia përfshihet shqiptueshmëria por kësaj hapen probleme për shkak të kriterit thjesht gramatikor që sundon dhe bën shpesh të detyrueshme cezurën mes fjalës...me kusht /shetizimin, heq pothuaj nga përdorimi formën *s'e dua* ose shton zanore fundore të paqena për të lehtësuar shqiptimin - është shtrenjtuar. Kjo përbën një kapitull të madh mbi rjedhshmërinë, të cilin gjuhëtarë e kultivuar e kanë zgjidhur me kohë. Shkrimtari ynë (kush e ka atë kërkesë...) duhet të ndalet e ta zgjidh or" e çast gjat punës tij; ndaj duhen kodifikuar se si përballohen përplasjet e padëshiruara mes bashktingulloresh, ashtu si apostrofi zgjidh zanoret që trondisin ritmin. Përzgjedhja në pasurinë dialektore bëhet me sens krijues e jo me konformim rregullit të ngusht, përjashtues; duhet pra të prijë shija, fantazia, që nuk përfillin skrupujt e drejtshkrimit zyrtar - shtriti prokrustian ku tepër gjatë redaktori mbajti nën zotërim dhe masakroi autorin edhe në gjuhë, e jo vetëm për brendin ideologjik. Frut i këtij procesi përzgjedhës/miratues që e ruan fjalorin mbarshqiptar do të jetë një fjalor sinonimik në sensin që thamë më lart, të nuancave kuptimore që do tu jepin varianteve ortografikisht të ndryshme të së njëjtës fjalë.

## DEMET QE DUHEN SHMANGUR.

Provë flagrante e triumfit në dekadat e diktaturës e *mësuesis* mendjengushtë mbi *intuitën* kreative, ka qënë botimi tash vonë në shqipë standarte e teksteve arbreshe pa originalin pranë. Në to i jepet lexuesit "kuptimi" i poemave dhe u hiqet poezia. Një efekt rënues. Këtu na pruri dekadencia e shijës që rezultoi nga ngrtësia e standartit, e planifikuar dhe e zbatuar pa asnjë lëshim, si një letërsi shkruar, që vetëm duke iu bindur korrektoreve letrar-përmbytësorë do të siguronin të drejtën e botimit.

Reforma e viteve 70 solli në fakt triumfin e uniformizimit *dhaskalist*, aty ku larmia dhe afërsia mes dialekteve ekzistonte dhe duhej harmonizime me pasuri trajtash. Duhet tani e kundërta. Të vihet në program sëpari përvehtësimi nga gjenërat e re e pasuris gjuhësore që gjëjm tek shkrimtarët e vjetër e të cituar përmbledhtaz nga Kristoforidhi, e poezis popullore (Eposi i Veriut etj), asaj Jugore, Arbreshe, dhe e kontrbutit të krijuesve të mëvonshëm, sigurisht mbas një qëntimi të rreptë për të nxjerrë vlerat letrare, e pa donjë detyrim të madh kundrejt autorëve me

emër por që s'paraqesin vlera artistike. Duke qënë geg vetë por në kufi të Toskëris, Kristoforidhi me dy Dhjata, sëpari gegnisht, pastaj toskërisht, dhe me Fjalorin, del babai i gjuhës letrare moderne. Kontributi i tij si autor mbeti panjohur për publikun e sotm(?). Duke cituar në Fjalor dialektet dhe autorët e vjetër, ai sikur na jep qysh atëhere orientimin që theksuam më lart, të një harmonizimi-integrimi me kohë të dy dialekteve. Ai jep landën e plotë të leksikut që duhet të shërbejë si bazë. Disa qindra fjalë të vjetra, arbreshe e dialektale janë asgjë për trurin rinor, jo vetëm, por me një program të studiuar që përzgjedh ato më me vlerë, fondi i memorizuar do të përbëjë një kapital të vërtetë për letrarët e ardhm. Deri edhe në shkolla profesionale nxënësit t'i njohin majat e poezis sonë ashtu si janë, t'i recitojnë dhe t'i nxëjnë përmendësh, kurse ata të gjimnazit të zgjerohen mbi to. Më shumë se leksionet historike, ose sëbashku me to por të nënstruara kritiks moderne, poemat origjinale dhe burimore, ngrajn ndërgjegjen estetike të nxënësit, rritet aftësia e tij evokative mbi



vargjet që dëshmojnë situata historike të vërteta, në vend të atyre të rrumbulloura o të sajuara të derisotme, retorike dhe shpesh false. Kur i riu i një ngjarjet historike përmjet gjuhës origjinale të poetëve, dhe gojës së anonimëve popullorë, kur ndien dhimbjen që i përshkon, në vend të fryrjes bosh që i jep shpesh historiografia, do të krijohet lidhja e vërtetë me të kaluarën, dhe kështu rrekuperohet njësimi me atë kohë, deri sot i shmangur për shkak të problemeve që i nxjerr tezës *shqiptari pa faj-fajtorë janë të tjerët*. Dhe kështu brezi i ri fiton një ndjeshmëri reale mbi historinë, si një nisje për vetformim serioz.

Lënda e gjuhë-letërsisë për një komb si i yni dhe në kushtin tepër delikat të momentit duhet të përbëjë shtyllën kurriore të shkollës; përmes letërsisë burimore, mitike dhe historike, dhe një kulture të hollsishe mbi gjithshkura arbore e shqiptare, me të mirat e sidomos të hidhurat e historis, brezi që rritet t'i njohi vlerat reale dhe jo sajesa që me kohë bien posht duke e lanë pa një vetdijë të mirfilltë kombtare. Dobia e një mësimi të tillë, do të pasqyrohet te krijimet e nesërme, të një sinqeriteti shpresojm që i shkon kohës sotme në botë, rrenjësisht kritike ndaj falsitetit të mbivendosjeve pseudovetërsuese. Jemi të vonuar në këtë kthesë autokritike, por

më e negative është fryma nihiliste që po e mbush momentin dhe çon krijën tonë të identitetit në kufij të rrezikshëm. Vlerat duhen kërkuar të humbjet tona historike, një humbje e tërë tejpërtej, por duke zbuluar çka ka rezistuar brënda saj dhe mbi të gjitha pesë e humbjes dhe të rezistencës. Gjëra këto që e tejkalojnë materializmin me të cilin janë edukuar dy brezat e mbramë, dhe vë në pah gati inkoshjencën, instinktivitetin e atyre më të hershëm. Ato gjenden dhe do të zbulohen te

## Niveli i shijës

Niveli i shijës që zgjedh/dominon mjetet ngrihet dhe përsoset brënda një shkolle ku gjuha shqip dhe letërsia zëm vendin e parë si shqetësim intelektual i shoqis. Sepse me atë vendosje shprehja (letrare dhe shkencore) pranimi o skartimi i termave, do vijë si në të kaluarën, prej pëlqimit të atij që bëhet e përdorshme nga që miratohet prej elitës së vërtetë e jo të emëruar.

## Nuk na duhet koherenca dialektore

Nuk na duhet koherenca dialektore por loja estetike bashktingullore-zanore, pra del më e pëlqyer të kemi përzjerje kur kriteri eufonik krijon brënda fjalës lehtësi tingëllimi me fjalë përkatësie të ndryshme dialektore. Kështu fondi i gjuhës duhet trajtuar si një serrë me filiza të disponueshme prej çdo këndi të territorit. Serrë ku kryesisht poeti/shkrimtari zgjedh e propozon, dhe autoriteti gjuhësor me sens kritik mbi të gjitha pro shqiptimit të bukur konfirmim ose refuzon mbas një kohe të mjaftueshme për të provuar suksesin e tyre në masën e kulturuar. Integrimi me kohë të dy dialekteve.

këngët burimore nëse bashkë me to do të shfletojm studimet e të huajve mbi to. E tillë është fryma e sotme kudo në botë, më profesionale, kështu edhe bagazhi i plotë gjuhësor letrarohistorik, me të vërtetë e përmëtuara të gjithshkaj burimore, do të na rreshtojë te formimi bashkohor e kritik i vetdijës.

## MBI TË GJITHA LOGJIKA KREATIVE.

Esht edukimi me shijë të lartë që vepron mbi psikikën e të riut, me bukurin e tingëllimit dhe evokim të historis, e jo i derisotmi që e quan të papjekur të riun, pra të paafit për ta ndier dramën tonë kombëtare në shekuj, dhe e mbush me sajatat që thamë, që synuan dhe ia dolën të rrisnin breza të dëmtuar qysh në nisje. Çështja pra qëndron të luftohet doktrina materialiste që e vendos kutin e pedagogjisë te masa mediore e jo tek individi inteligjent; sot jemi në momentin që të veprojm në drejtim të kundërt, dhe ta "ngarkojm" trurin e të riut me detyra të shumfishta. Fjalët e rralla tek poemat na lidhin me fazat që ka kaluar gjuha, dhe kjo lloj lidhje frymëzon me vjetërsit që bart, dishka përtej të kuptuarit, që merret gjoja me ngjarjet historike por s'lidhet dot me atmosferën dhe dramën e tyre. Duhet rindërtuar lidhja... Nga krahu tjetër autori aktual ka një botë për të shprehur, dhe një prej

një publiku të ngushtë. Sot duhet e kundërta e procesit që familjarizoi tek veriorët për 50 vjet toskërishten nën fytyrë standarti, me një afrim tash të jugorëve me Rapsoditë e ciklin mitik verior, me Fishtën e poetët gegë, pra një zgjerim ndjeshmërie e njohjeje kudo e me gjithshka që ka të bëjë me atë trashgimi. Për të mos qënë i njëanshëm, në shkolla diçka mësohet, fjalë është për një zgjerim të madh të lëndës me shtesë orësh e trajtime të hollësishe (edhe përmendsh siç thamë) të autorëve dhe folklorit kulmor. Në kushtet e garës globale nuk ka pasuri më të rëndësi për ne se gjuha, dhe s'ka mjet më efikas për ta mbrojtur e kthyer në pjellore se sa një shkollë me profil të theksuar filologjik. Vërtet talenti është primar, por për tu kultivuar ai, njohja me hollsi e të gjitha vlerave të krijuara deri sot merr rëndësi parësore. *Degët* e së njëjtës rrenjë të promovuara paralelisht, kanë një fuqi frymëzuese të pandier, kurse norma e vendosur nga gjuhëtarët, aq më keq mbi një bazë paraparakisht të ngushtuar, ua kalon atë si parzmore poetëve e prozatorëve siç po e konstatojm shumë shpesh; ajo bëhet veçanërisht penguese për ata shkrimtarë që i tërheq më shumë tingëllimi sesa brendia kuptimore. (Të mos harrojm formulën e Verlaint: "*De la musique avant tout chose*").

Vetë idea e një stadarti tek ne ka qënë edhe e parakohëshme edhe varfëronjëse. Po të heqim gjuhën e shkresave që kërkon qartësi për të shmangur keqkuptime me dem praktik (veçanërisht jargonin gjyqsor), e tërë sfera që mbetet, letërsia, teatër, film, poezi, vetëm dobi do ketë prej të folmeve popullore dialektale e madje argove, dhe doemos prej modeleve ekzistuese tek poetët më të suksesshëm. Kjo praktikë njihet kudo në botë, ajo krijon pasurinë e fjalorit, nuancat kuptimore, sinonimet që i japin dorë shkrimit me fantazi. Guximi krijues ka shumë për të nxjerrë prej licencave të goditura. Shkolla duhet t'ua bëjë të njohur fëmijëve letërsinë më të vlefshme të të gjitha trevave, ashtu siç është, veprat e shkrimtarëve kudo ku shkruhet shqip. Kthimi i shkrimtarit e lexuesit tek folklori dhe tek shkrimtarët e lashtë mund të jetë e vështirë veçanërisht mbas karantinës ndaj çdo gjëje që lidhej me fenë, por do ta shtojë e thellojë njohjen e shpirtit arbër e shqiptar; shkollësi i bie të jetë në vendin e parë të kësaj detyre.

## PENGESA QE DUHEN KAPERCYER.

Mund të paraqesë problem se si leksiku i panjohur bëhet i pëlqyer te lexuesi mbasi ka tërhequr poetin e prozatorin autor me ekzotizmin/nostaljinë e tij. Ajo lloj poezie e vëmendshme veç te përmbajtja, e shmang fjalën pak të njohur nga frika e tronditjes së komunikimit, ajo don që tingëllimi të kthehet në kuptim sakaq. Zgjidhja e problemit vjen indirekt, nga prurja e shumëzuar prej botimeve, që kthehet në njohje-pëlqim-përdorim sipas shijës së autorit, pra do një farë kohë, dmth një proces familjarizimi. Por mjafton të kujtojm sesi i bëjm tonat edhe fjalë të panjohura prej vlerës së kontekstit që na rastis të na magjepsë. Shkurt duhet të pasurohet tregu letrar, dhe për këtë du-



# A

## ARGUMENT


→ Vion nga faqja 15

### NGA LEKË TASI

het më parë krijuar interesi për letërsinë nëpërmjet leximit e recitimit, teatrit cilsor në shkolla dhe mjedis të ndryshme. Të propagandohen të gjitha tekstet me vlerë që ofrojnë burimet gjuhësore të Veriut, Jugut, dhe atyre jashtë kufive e diasporave, dhe të mënjanohen nga programet ato pa vlerë. Kurse pjesa teorike e mësim-it, (ç' janë rrymat, klasicizmi, romantizmi etj), nxënësi i merr dhe i vlerëson po që i interesuar nga veprat. Primare është magjepsia nga forma, dhe forma varet shumë nga pasurimi paraprak me gjuhën e kohërave. I riu përvetson gjithshka, sado ta ngarkosh, kështu na mëson psikologjia. Shkolla e çdo niveli duhet të përqëndrohet pra te mjetet, shqiptim-recitimi, sintaksi, gramatika, por me një metodë praktike, duke i nxjerrë ato prej teksteve, pra me një konkretësi që bashkon zbulimin e rregullave me kënaqësin. Shembujt novatore në shkelje krijuese të sintaksit ose licenca të tjera të jenë të rrethuara me kornizë tek faqja e librit, për tu fiksuar në tru. Kjo përbën përparësinë absolute në gjendjen stanjante që jemi. Politika arsimore e deridjeshme ka bërë të kundërtën, ka reduktuar larmin tek rregullit, madje ka hequr fare lëndën e gjuhës, me pasoja rënuese për aftësinë shprehëse të qytetarëve, rënien posht të nivelit letrar në masa (shkrimtaria masive e reduktuar në formula, romantizëm demode, moralizëm të hapur, libra komercialë etj), ndërkohë që ai i krijueseve të veçantë është rritur shumë por pa merituar vëmendjen e duhur; i pikërisht ndodhin procese të kundërta nga ai kur ishim nëndiktat. Mundet ky polarizim dije-padije ndodh kudo në botë prej dekadencës së leximit në favor të lojrave kompiuterike e zbatimjeve të tjera. Vetëm nëse do të arrijm të nxisim leximin tek qytetarët e më shumë tek rinia, teatrit cilsor në shkolla, do të vijë kthesa. Dhe atëherë do këtë vend për të hyrë në garë me letërsinë e huaj, gjë që në afat të gjatë vlen po aq sa ekonomia e mirë dhe jeta metropolitane për afirmimin e Shqipërisë si një kënd origjinal i Evropës. Do arrijm pjesëmarrjen në garë kur identiteti ynë të ofrojë vepra, art, mënyrë jetese interesante që tërheqin publikum sepse gjen aty tiparin e vet vendës të zbuluar artistikisht, dhe bëhet tërheqës edhe për të huajt.

### PURIZMI DHE HUAZIMET.

Lartësimi të nivelit letrar i duhet shtimi i larmisë në fjalor. Ky është një problem i madh, mbasi ndesh me purizmin patriotik mjaft të përhapur. Mendimi purist preferon një shqipe të pastër (por sa e pastër është ajo?) kundrejt asaj që huhet vazhdimisht sëjashmiti terma e fjalë që i mungojn krejt ose që i vlej si sinonime. Prirja për t' i



### Ide e parakohëshme

Vet idea e një stadardi tek ne ka qënë edhe e parakohëshme edhe varfëronjëse. Po të heqim gjuhën e shkresave që kërkohet për të shmangur keqkuptime me dem praktik (veçan në jargonin gjyqësor), e tërë sfera që mbetet, letërsi, teatër, film, poezi, vetëm dobi do ketë prej të folmeve popullore dialektale e madje argove, dhe doemos prej modeleve ekzistuese tek poetët më të suksesshëm. Kjo praktikë njihet kudo në botë, ajo krijon pasurinë e fjalorit, nuancat kuptimore, sinonimet që i japin dorë shkrimit me fantazi. Guximi krijues ka shumë për të nxjerrë prej licencave të goditura. Shkolla duhet t'ua bëjë të njohur fëmijve letërsinë më të vlefshme të të gjitha trevave, ashtu siç është, veprat e shkrimtarëve kudo ku shkruhet shqip.

theks paroksiton. Por ç' rëndësi ka ky komoditet kur shqipja i ka të natyrës saj, pra të domosdoshme zanoret e gjata për të qënë shqipe e zëshme, dhe shkurtimi i tyre me anë të ë-së, denatyrën të folurën në pjesën më të madhe të territorit?

# ARSYET PSE DUHET BRAKTISUR STANDARDI I 1972

shmangur bëhet shkak që me kohë ato të hyjnë dhunshëm e pa kulturë. Mënyra më e mirë për një pasurim real është të ligjësohen me autoritet ato huazime që sigurojnë jo vetëm zërin e duhur për një koncept ose objekt që na mungon, po edhe sinonime për nuanca në psikologji dhe larmi stili në romanet tona. Që letërsia të bëhet më e fuqishme në kuptime dhe më elegante në mjete. Shkollës i duhet vut kujdesi edhe për sintaksin që e ka pasë dikur lëndë me vete, për një logjikë të fjalisë, por edhe për një liri në poezi duke e shkelur normën e ligjëruar me sens krijues. Kryesor mbetet rreshtimi i fjalëve në mënyrë që suksesioni zanore-bashkëtingëllore të jetë i një shqiptimi të këndshëm, sidhe që fondi dialektor, nga i veçantë të shndërrohet në të përbashkët, pa na e vrarë më veshin pranësia gege-toske. Aktualisht të inkurajojnë e folura e rrugës e ban këtë, konstatohet kudo, deri në parlament parasëgjithash trajta paskajore, e përdorur nga jugorë, (me e kujtu) dhe aq më mirë, e pasuar shpesh nga pjesore jugore (tue harruar). Pra po hyn ajo përzjerje, ai unikifikim veri-jug i mjetit më efikas gjuhësor për të shprehur parime, të cilin akademia jonë (instituti i gjuhësis, kongresi i 72) dënoi me vdekje përsëgjalli. Mendja e shëndoshë e popullit reagon. E dyta: zanoret e gjata, një pasuri e

gjuhës që dikur shtrëngonte veriorët të përdornin në shkrim zanoret të dyfishuara, dhe që fatqegësisht i ndien sot më rrallë. Fajtor direkt është standarti që ka ligësuar ë-në si rrokje, e cila i kthen në të shkurtra të gjitha zanoret, nëpërmjet shtimit të një ë-je pas çdo mbarese të gjindores, kallzores etj. e duke i numuruar si rrokje. Shëmbull: nëse 1-a fundore e fjalës liri shqiptohet e gjatë në emnore, në rasat e tjera, lirisë, lirinë etj. përfundon e shkurtër. Gjuha jonë i ka zanoret dy llujesh: I par (e gjatë, që ne e shkruajm i parë), kurse a tek ar, e shkurtër. Ky dëmtim i madh fonetik, erdhi nga standarti, që jo vetëm bazohet tek toskërishtja, por me shtimin e ë-së si më lart, zyrtarizon dialektin juglindor (kryesisht korçar, sikur të ishim ende në shekullin e XIX). Gjuhëtarët tanë kanë shenjtëruar këtë prirje konservatore por lokale, megjithëse qysh në vitet '20 e deri në vitet e para të pasluftës, kemi pasë një interval mjaft të gjatë me gjuhë zyrtare një gegnishte të moderuar me theksa, e cila e zgjidhte problemin. Ajo mund të vazhdonte po të mos qe motivimi politik i fshehur nën reformën. Argumenti kryesor i tyre - përjashtimi i theksave (dmth jo lirinë - me theks mbi i-në fundore, por lirinë, për të bërë theksimin e saj ndryshe nga liri (bimë)me

### EPERSIA FONETIKE E GEGNISHTES.

Dialekti verior është në masë të madhe ma i zashëm (përfshi këtu edhe rreshtimin e bashktingëlloreve, më estetik se toskërishtja (zbbij, zghatroj, i mpijt, kundrejt çtaros, çkatërroj, i mbirë). Duke qënë kryesisht një rroksh, po edhe me zanore te gjata/shkurtra, dialekti verior ka theksa të shpeshtë, gjë që paraqet një avantazh të shumfishtë, kuptueshmëri dhe tingëllim. Mund të thuhet se gegnishtja artikulohet, kurse toskërishtja mërmëritet. Një krahasim i guximshëm ky por mjaft afër së vërtetës, që mund të provohet statistikisht me krahasime në faqet e librave: sa më e pranishme është zanorja a dhe diftonget ku a ja prin (ai) në Veri dhe sa në Jug. A-ja konsiderohet kudo si zanorja ma e bukur. Ajo dominon në Veri: Bajm, bëzajm, hana, hajm, që në Jug i gjejm: bëjmë, bëjmë zë, hënë, vjedhës. Le të krijojm një fjalë tipike në dy variante do të na e jepte më dukshëm ndryshimin: Ledhat e bajn fminin ma t'kandshme, kundrejt Përkëdhellitë e bëjnë fëmijërinë më të këndëshme. Thuajse 18 rrokje kundrejt 9. Rasat janë gjithandëj. Eleganca e gegnishtes duket psh të dinamizmi i

tipit ndejnjo kundrejt ndënjur-hajes-ngrënies e panumur të tjerash.

Prej kohësh po zhvillohet diskutimi rreth ë-së, dhe ka shumë gjuhëtarë,shkrimtarë, e sidomos poetë, që këmbëngulin për suprimimin zyrtarisht të saj në disa raste ku standarti e ka fiksuar. Kundërshtimi i autoritetit zyrtar gjuhësor nuk lëviz, madje shkolla ka bërë që të hyjë vesi i zvarritjes me ë edhe atje ku s'ka qënë. Po edhe zhdukjen e saj në vende që duhet pa tjetër si te shumsi dhe te lidhorja (një skandal që përfshin edhe plot intelektuale, të panumur!). E pakuqteshme mospjesëmarrja e shumë personaliteteve nga Veriu, që kanë për detyrë të ringjallin traditën letrare të konsoliduar me shekuj mbi themelet e shkrimtarëve mesjetarë dhe të folklorit. Pa njohjen dhe performimin e tij të përdituar me botime e recitime tashmë të kuptueshme në tërë territorin, gjuha shqipe dhe kultura shqiptare hyn në një varfërim të rrezikshëm. Pikërisht këtu shohim nevojën e një shkolle me karakter letrar të përfortuar, qysh në nivelin fillor, dhe me karakter thellues në nivelin e mesëm dhe të lartë. Puna intensive për një fjalor etimologjik dhe sinonimik jo të thjesht por pasqyruet të gjithë pasuris leksikore të hapësirës shqiptare me nuancat që kanë ose do tu jepin sinonimeve do të ndihmonte shum, por edhe guximi i shkrimtarëve për të huajtur prej kësaj pasurie, sado në luftë me ndjeshmërinë e secilit për të qënë i natyrshtëm sot për sot. Ky është një problem serioz; do të zgjidhet vetëm me anën e atij fenomeni të njohur por me afate të gjata, të kalimit nga repulsiioni tek familjarizimi me të renë. Po përmend vetëm një shembull skajor për nga guximi: përkthimin e Simposiumit të Platonit nga Shpëtim Doda, me termin Bashkëpirje. Mund të pranohet, mundet jo. Por kur hyn e lexon tekstin, fillon të ndiesh se hyrja e neologjizmeve të padigjuara më parë, të krijuara si përkthime drejtpërdrejt nga origjinali ose të nxjerra nga gjuha e ulët, e bën gjuhën një fushë për lojë. Nëse rezultati pëlqehet, qoftë me pakicë, kontributi është i vlefshëm. Kontributi me fantazi, do të jenë një temë plus për diskutim, e rëndësishtja është të kenë nivel estetik, por edhe efektin befasi që hyn si përbërës në stile me kërkese të veçanta. Po në atë libër kemi edhe orientalizma. Masa se sa duhen përdorur ato luhartet historikisht me maksimales së Bejtexhivë, purizmit absolut të Naimit, ringjalljes së tyre mjaft të theksuar nga Noli (te Don Kishoti e jo vetëm), dhe sot në masë të moderuar te Doda, që i ka marrë prej të folurës së gjallë ende sot. Ato mbeten një mjet për tu pasur në konsideratë.

### SI PERFUNDIM,

niveli i shijës që zgjedh/dominon mjetet ngrihet dhe përsoset brënda një shkolle ku gjuha shqip dhe letërsia zë vendin e parë si shqetësim intelektual i shoqnis. Sepse me atë vendosje shprehja (letrare dhe shken-core) pranimiti o skartimit i termave, do vijë si në të kaluarën, prej pëlqimit të atij që bëhet e përdorshme ngaqë miratohet prej elitës së vërtetë e jo të emëruar. Pra duhet të vendosë shija e rafinuar e poetëve dhe prozatorëve, jo ajo e gjuhëtarëve. Dhe kritëri i padiskutuëshëm është shkurtësia. Atë na e siguron dialekti verior:

# P

## POEZIA

*Autori na përcjell një pjesë nga krijimtaria e vet e kohëve të fundit. Me shumë kujdes, por edhe me finesën që e shoqëron krijimin e vet, duke përdorur një figuracion modern, autori na jep perceptimin e kohës ku jetojmë, por sjellë nga vende të huaja, ku gjithnjë e më shumë ka jetuar në vitet e fundit...*

NGA ANTON PAPLEKA

### DY ZEMRA TË VIZATUARA NË BORË

Duke shëtillur nëpër Zvicër  
Vizatova me gisht një zemër  
Pranë një zemre tjetër  
Te vizatuar nga një person i panjohur  
Në borën që ndodhej buze rrugës

Të ngrohura nga dielli rrezellitës  
Që u dukë sikur ishte binjaku i tyre  
I vizatuar nga ndonjë Pikaso ndëryjor  
Në xhamin e qjellit të kalter  
Dy zemrat e vizatuara në borë  
Zunë të rrinin së bashku

Për çudinë time  
Çjaku zuri të rridhte  
Nga njëra zemër te tjetra

Ato zunë të flisnin  
Te njëjtin ligjërimit dashurie  
Te shprehnin mahnitjen e tyre  
Para bukurisë së peizazhit  
Para diellit rrezellitës...

Kur u ktheva më vonë tek ai vend  
Nuk i pashë gjëkund  
Dy zemrat e vizatuara në borë

Ato ishin afruar ishin përqaftuar  
Derisa ishin pëzier me njëra-tjetrën  
Si të gjitha zemrat e të gjalleve  
Te përflakura nga dashuria e marrosur

Wernetshausen, 27.I.2017

### IMAZHI I PASHQITSHËM

I zgjuar në të zbardhur të dritës  
Unë shoh ca tufa bari të thate  
Përtej xhamit të dritares sime

Murlani i akullt  
I tund hove-hove  
Para syve të mi të mbushur me natë

Ato tufa bari të thate  
U ngjajne cullufëve të flokëve  
Të një njeriu të pastrehë  
Të shtrire mbi borën e ngrirë  
Të vdekur nga acari

Në qoftë se ai ka thirrur kur unë filja  
Perse nuk i kam degjuar  
Thirrjet e dëshpëruara?

Përse nuk jam ngritur  
Nga shtrali i butë dhe i ngrohtë  
Për t'ia hapur deren time  
Dhe për t'ia shpëtuar jetën?

Murlani tund përtej xhamit  
Tufat e bari të thate

Ato u ngjajne gjithnjë  
Cullufëve të një njeriu të pastrehë  
Që këtë natë dimri  
Vdiq diku nga acari

Dita që po gdhin  
A do të më shpëtojë vallet  
Nga ky imazh i pashqitshëm?  
Looren, 29.I.2017

### KORIJA E MBULUAR ME BORË

Sa e bukur është kjo korije  
Që ngrihet buzë rrugës  
Me degë të argjenduara nga bora e ngrirë

Në çastin që kaloj pranë kësaj korije  
Ajo shtrin një nga degët e saj  
Më flon t'i afrohem  
T'i dhuroj fllorën e bardhë të frymës sime  
Për ta mbajtur rreth majës së drurëve  
Si një shall të mëndafshitë

Sidomos ajo kërkon t'i jap  
Pak nga ngrohësia ime njerëzore  
Për t'u mbrojtur nga të ftohtit e pameshirshtëm  
Të natës që afrohet

Tepër e gjatë do të jetë kjo natë  
Për korijen e mbuluar me borë  
Si një grua e re veltitare  
Që fergëllon në shtrat pa venë gjumë në sy  
E shqetësuar nga rënkimet e erës së acartë

Këtë muzg dimri  
E veltmja gjë që mund të bëj për këtë korije  
Është ta marr me vete imazhin e saj  
Dhe ta strehoj nën qepallat e mia  
Duke qenë i bindur  
Se dhembshuria ime nuk do t'ia ndryshojë fatin

### PEIZAZH ME NJË KODRINË DHE ME NJË LIQEN

Një kodrinë e madhe ngrihet para meje  
Nën qiellin dimëror të Zvicrës

Ajo i ngjan shpinës së një lope të larme  
Ku larat e zezë të pyjeve me bredha  
Nderthuren me larat e bardha të lirishtave  
Te mbuluar me një shtresë të trashë bore

Përtej asaj kodrine të madhe  
Simulakër i lopës milike Hathor  
Ravijezohet një varg i gjatë malesh  
Si muri që ndan kullolat  
Në një poemë të Robert Frostit

Rrezë kësaj kodrine të madhe  
Shtrihet një liqen i stërzgjatur  
Si një viç që ka mbledhur gjunjët  
Për t'u ulur nën barkun e nënës së tij  
Për të thithur siset e fryra nga qumështi

Kur të shkrihet bora  
Rrëkele e ujerave të kristallta  
Do të rrjedhin nëpër shpatet e kodrinës  
Dhe do të derdhen në liqen  
Duke gurgulluar si curilli i qumështit  
Që rrjedh në fylin e një viçi të etur

### NË REZIDENCËN E JOYCE-IT

Zotni Joyce  
Unë e di se ti ke qenë një Uliks  
Siç e di se çdo njeri  
I denjë për atributin *shkrimtar*  
Është kipi i Uliksit

Zotni Joyce  
Dua të të bëj një pyetje të thjeshtë:  
A ke mbërritur në Itaken tënde?

A ekziston vërtet një Itakë  
Për shkrimtarin e njëmendte?



Unë besoj se Itaka e vërtetë  
E një shkrimtari  
Janë librat që ka shkruar ai

Qysh nga fëmijëria  
Një shkrimtar lundron  
Duke u rënë kryq e tërthor deteve  
Për të mbërritur në portin që quhet  
Libri i tij i jetës

I rrethuar nga vëllime të trasha  
Të botuara në të katër anët e botës  
Unë kam dëshirë të trokas  
Në ballinat e tyre  
Si në kanalën e një porte  
Dhe të thërras:  
A je këtu, James Joyce?

Mbi raftet e mbushura me librat e tu  
Ndodhen disa shishe:  
A mos vallë do të na japësh nga një gotë  
Për të festuar me ty ditëlindjen tënde?!

Me thënë të drejtën ti lind  
Sa herë që dikush merr në dorë  
Ndonjë nga veprat e tua  
Dhe përkulet mbi fletë  
Siç përkulet Uliksi i lashtë  
Mbi detin ngjyrë vere...

Duke veshtruar një derë të mbyllur para meje  
Kam përshtypjen se papritmas  
Ti do të futesh në këtë kthinë  
Për të pershëndetur vizitorët që kanë ardhur  
Në rezidencën tënde në Cyrih

E falënderoj këtë qytet  
Plot katedrale e pallate të madhërishe  
Që rezidencën tënde të mbushur  
Me dorëshkrime me fotografi me botime  
E ka shndërruar  
Në një tempull të letërsisë

Duke u larguar nga rezidenca jote  
Do të marr me vete dy fraza  
Që ti i ke pasur për zemër  
Dy fraza të afishuara në mure:  
« Nulla dies sine linea »  
« Joyciens, ju përbez » ...

1. James Joyce ka lindur më 2 shkurt 1882

Zurich, 2 shkurt 2017

### MUZG NË ZVICËR

Qielli në perëndim  
I hullizuar nga re të hirta  
Është një bokal  
I mbushur me ujë të kulluar  
Ku pluskonin të shpërndara  
Disa petale  
Trendafilash  
Të kuq...

### SFINKSI I VETMISË

Ajo ishte macja më e bukur që kisha parë ndonjëherë

Ngjyrat e gëzofit të saj prej tigri  
Lodronin në kurrizin e saj  
Harmonizoheshin me njëra-tjetrën  
Si notat e një partiture

Ajo mace ishte si mishërimi  
I një perëndie feline të Egjiptit të lashtë  
Si mishërimi i një kafshe tolemike

Kur kaluan nëpër fshatin e saj  
Ajo erdhi nga oborri i një shtëpie të pabanuar  
Me kanale të mbyllura me drita të fikura

Ajo na u qas me druajtje  
Pastaj zuri të ecte bashkë me ne  
Duke ngritur lart bishtin e saj të bukur  
Si një flamur që valëvitet në erë

Në falëm disa ledhatime  
Që ajo i priti si dhurata  
Por ne nuk e shpëtuan dot nga vetmia

Në nuk ia zëvendësuan dot  
Të zotët e saj për të cilët e kishte marrë malli  
Dhe i priste me padurim

Në çastin që u larguam prej saj  
Ajo u ndal në mes të rrugës

Dhe na ndoqi pas me vështrimin e saj të trishtuar

Macja e kuptoi se ne nuk ishim  
Burri dhe gruaje që ajo priste

Kur e ktheva kokën pas  
Për ta veshtruar për të fundit herë  
E pashë të shtangur në mes të mugetrës

Ajo dukej si një sfinks

Wernetshausen, 5.II.2017

### MJEGULLA

Duke soditur mjegullën e lebardhme  
Që mbulonte rrethinat e Hinviit  
Më erdhi ndër mend  
Vargu i një balade shqiptare:  
„I ra mjegulla Buenës...“

Mjegulla që mbulonte rrethinat e Hinviit  
M'u duk si fustani i bardhë  
Që mbante personazhi i baladës së moçme  
I murosur për së gjalli  
Në themelet e keshjellës së Shkodrës

Duke përsiatur për këtë rit themelimi  
Të lidhur me besimet e stërgjyshërve të mi  
(Në të vërtetë me një besim universal)  
Kisha përshtypjen se unë isha stërnipi  
I nuses së sakrifikuar në ritin e lashtë

Unë kisha përshtypjen  
Se ajo mjegull ishte qumështi i avulluar  
I pikuar nga gjiri i shndërruar në gur gëlqeror  
Nga gjiri i nënës së re të murosur për së gjalli  
Në keshjellën e target të Shkodrës

Ajo mjegull e lebardhme ishte  
Edhe mjegullinaja e legjendave stërgjyshërore  
Pjesë e pandarë e qenies sime  
Që më ndiqte pas nëpër rravimet e jetës  
Me ndriçimin e saj qjellor

Hinwil, 11.II.2017

### NJË GRUMBULL BORE

Një grumbull bore  
I mbetur buze rrugës  
I stërpikur nga rrotat e makinave  
I ngjan shukut të një letre të zhubrosur  
Ku dimri kishte shkruar një poemë  
Që nuk i është dukur e arrirë

Ky grumbull bore  
I lëbytur nga rrezet vezulluese  
Veshtron rreth vetes  
Me bebezat e tij të kristallta të panumërt  
Duke fergëlluar e duke pëshpëritur:  
*Ç'arë bëj ende këtu?!*

I llahtaritur  
Nga syri ciklopi i diellit  
Që dëshiron ta përpjete  
Ai nuk e shpjegon dot urrejten e tij të tmerrshme  
Përbelimin e tij  
Për ta zhdukur nga faqja e dheut

Midis një bote jomikpritëse  
Ai përsërit gjithë ditën e ditës  
Monologun e tij të shkurtër:  
Sa e rëndë qenka  
Të jesh fisi i fundit  
I popullit shumëllojës të flokëve të borës  
I denuar të zhdukët...



kadifeje me ngjyrë të purpurit dhe ekspozoheshin në arkëza të vockla me xhamin kristal me zbukurimet që bëheshin për t'u përshtatur. Përveç trofeve të gjetisë, oborri në Konopiste ishte plot me orendi që karrocet e Frantishekut i sollën nga vila e tij e dashur Ville d'Este. Pastaj kishte edhe armët mu atje, një armaturë me të gjitha llojet e armëve, gjithsej 4618 copë. Përveç fiksimit të tij për bizonët, Franz kishte një afekcion të veçantë për Shën Gjergjin, kështuqë ai mboldhi edhe plot 3750 skulpturëza të vogla të martirit kristian teksta vret "dragoin". Arqiduka Ferdinand ishte një koleksionist i thekur. Ai koleksiononte anti-kitete, piktura të piktorëve "naivë", orendi fshati, turilillog gjërash të vogla dhe të mëdha të dobishme dhe të padobishme prej qeramike, gurë dhe mineral, vitrazhe, ora dhe medalje.

Kështjella ishte e rrethuar nga një kopsht i gjithë trëndafllash plot hapësirë. Kopshtin e vizitonin miq dhe mjeshtra të hortikulturës që kur e shikonin kopshtin, secilit do i dilte ndonjë *aaah*. Mes trëndafllave qëndronin një numër i skulpturave të Renesansës.

Tridhjetë e pesë vjet më vonë, oborri në Konopiste i tërhoqi vëmendjen oficerëve të lartë SS, të cilët e shndërruan atë në një vend-pushimi për vete. Hitleri vendosi që pjesën më të madhe të koleksionit të Ferdinandit ta përcillte në Muzeun e Wehrmacht-it në Pragë. Hitleri po ashtu vendosi që 72.12 ekspozante t'i zhvendoste në Vjenë e "pas lufte" të vendoseshin në koleksionin e tij personal ende të pandërtuar në Lins. Përpara se të shkonin në Konopiste, nazistët urdhëruan që kështjella të lyhej me të zeze brenda dhe jashtë.

Më tej, Franz Ferdinand-i e la vend-gjyqin Konopiste për Vjenën ku hipi në "Eoheiner Bahn" (linja Venecia-Trieste) dhe ndaloi në urën hekurudhore në vendin Solkan/Salcano, në të vërtetë në ngushticën përmes të cilit rridhte lumi Soëa/Isonzo, jo shumë larg prej Gorizia / Nove Gorice, sot në kufirin sloven/italian që tani serish është zhdukur pothuaj nën kufirin e ri, sigurisht atë historik, që përbën lindjen e një perandorë tjetër-Europiane. Luan një bandë tuxhi, malëvitin flamur dhe banderola të monarkisë së Austro-Hungarisë, flamuri verdhë e zi që atëherë duket pak i tejkaluar, ai i kompromisit, flamuri *Ausgleich*, dhe flamuri i marinës tregtare kuqbardhë-të gjelbër me dy kurora, pastaj edhe flamuri i luftës *Kriegsflagge*, që nuk do të zhdukej as edhe tetë vjet më vonë në vitin 1915.

Është e enjte. Qielli është i pastër. Herë pas here fluturon ndonjë zog i vogël i rastësisht, i shpejtë, si të jetë ndonjë sy i shqetësuar. Nga hijja e ftohtë nën urë pluskon një fllad i lehtë me kundërmimin e lulëzimit të luleve, degëve të reja të pishës, ujit të ftohtë dhe myshkut. Soëa rrjedh e qetë dhe e pastër; merr frymë njëherazi dhe thellë.

Më të shumtët janë fëmijë pasi në verë kanë pushimet. Dhe, shumica e tyre lodrojnë sepse janë fëmijë; nuk ja kanë fare dënimet historisë. Saktësisht pas dhjetë vitësh, të njëjtët fëmijë, mu në të atë vend, zhytur në transethe e tyre, do zvarriten nëpër baltë, pastaj do zhduken në Soëa, dhe pamjet e atyre ditëve festive të verës thyhen përmes pragjeve të egërsuara të "ujit të shenjtë" të smeraldit si xixëllonja, si inulla, si një jehonë dhe do rresqasin nën kapakët e kapsallitës së tyre duke pëshpëritur "lamtumirë" në të paktën



Vijon në faqen 20

## ARGUMENT

NGA MERI LALAJ

Shkrimtari, studiuesi dhe publicisti Myzafer R. Berberi, përveç botimeve të mirëfillta shkencore në fushën e radiobiologjisë, është autor edhe i shumë botimeve letrare. Në kolanën e tij krijuese përfshihen katër romane: "Përtë dashurisë", "Ndodh edhe kështu", "Dashuri në mister", "Kulla e nëmun", dy vëllime me tregime "Skaje", "Te vërtetat e ëndrrës", rreth njëzet studime monografike, mbi tetëdhjetë artikuj kritikë për artin, letërsinë, kulturën, publicistikë shkencore, mbi njëqind e tridhjetë tregime e novela, të cilat janë botuar në organe të ndryshme si gazetat: "Shqip", "Drita", "Ndryshe", "Temp", "Nositi", "Integrimi", "Koha Jonë", "55", "Telegraf", "Nacional", "Ushtria dhe Koha", "A. S.Pushkin", "Bashkimi D e m o k r i s t i a n", "P o l i Qendrës", "Miqësia", po ashtu në revistat "Shkenca dhe Natyra", "Shkenca dhe Jeta", "Mbrotja", "Koha Jonë", "Revista A", "Super Seks" etj.

Krijimtaria e tij shtrihet përtej hapësirës shqiptare me subjekte, episode, personazhe dhe me tradita kulturore të popujve të ndryshëm të botës: Gjermani, Angli, Itali, Francë, Rusi, Spanjë, Kanada, Amerikë, Kongo, Xhamajkë, Filipine, Kinë dhe Indi, vende me të cilat ai jo vetëm mban të ndezur dhe zhvillon më të kërshtërë dhe erudicionin e lexuesit, por edhe afron kulturën e këtyre popujve me atë shqiptare.

Krijimtaria e Myzafer R. Berberit për nga vetë tematika e veçantë dhe stili i tij original ka tërhequr vëmendjen e studiuesve: Amneris Drenofci (Haveriku), Dhimitër Gegprifti, Zenun Fero, poetit dhe shkrimtarit Përpamir Hysi, përkytheses dhe publicistes Dr. Shkencave Filologjike Myzen Shaplo, shkrimtarit dhe studiuesit Prof. Dr. Ilinden Spasse etj., të cilët kanë vlerësuar krijimtarinë e tij si një prurje të re e mjaft cilësore në letërsinë shqipe.

Kultura e gjerë shkencore e këtij autori në fushën e mjekësisë, fizikës bërthamore, veterinarisë dhe letërsisë hapin gjithnjë ditare të reja në krijimtarinë letrare.

Në librin e tij më të ri me tregime dhe novela titulluar "Të vërtetat e ëndrrës", ky autor shfaqet sërish para lexuesit me prurje të reja. Në këtë libër, nëpërmjet figuracioneve letrare, autori bën përballjen e botëkuptimeve të ndryshme mbi jetën, ndjesitë, dashurinë, familjen dhe shoqërinë.

Altruizmi, sikurse dhe në veprat e tjera të tij, është karakteristikë e veçantë edhe në këtë libër, dashuria për njeriun është mesazhi themelor në të gjithë krijimtarinë e tij. Tregimet "Tano Çollku", "Rasheda", "Një dhimbje e mbetur" e tjera.

Autori mban qëndrim kritik ndaj cinizmit, egoizmit, ambicive keqdashëse, hipokrizisë, spekulimeve në dallimin midis vlerave dhe antivlerave të shoqërisë këtu veçojmë tregimet "Hija e burgut", "Mekatat nga zil-

Një vlerësim për një krijes nga autorja Meri Lalaj. Referuar saj, prurja e kësaj filozofie në letërsinë shqipe nga shkrimtari Myzafer R. Berberi është një vlerë e re e çmuar që mban origjinalitetin e tij...

# Një botëkuptim i ri në filozofinë e letërsisë shqipe



Meri Lalaj

ia" etj.

Myzafer R. Berberi me sarkazëm dhe humor ndëshkon karakteret e dobëta të njerëzve meskinë e të djallëzuar si për shembull; ish-punonjësit të sigurimit të shtetit, të cilët i përball me fuqinë morale të njerëzve të thjeshtë e të ndershëm në tregimet "Kapter Sakua", "Grumka", "Shenja", "Gomari i Pilos" etj.

Autori në mënyrë të kujdesshme dhe të adhurueshme sjell në kundërti vlerat dhe bukurinë e dashurisë së thjeshtë e të vërtetë ndaj atyre ekzistenciale tek tregimet "Rasheda", "Një dhimbje e mbetur", "Shenja në pajë" e tjera.

Tematikat në këtë vëllim me tregime dhe novela janë të larmishme, të skajshme, një aftësi e veçantë e autorit që të lë përshlyerjen e një miniere vlerash të pa-shtrëngueshme.

Sentencat dhe "legjendat" e përdorura në këtë libër janë të përzgjedhura në funksion të subjektit që sjellin kulturë të lexuesit dhe e pasurojnë edhe më shumë vlerën e librit. Kujtojmë gjithashtu që kjo është një aftësi e qëndrueshme e autorit e shfaqur në të gjithë krijimtarinë e tij.

Një veçori me vlerë të madhe e këtij autori është fjalori i pasur, i bukur, i pastër i gjuhës shqipe, madje ndonjëherë në mënyrë mjaft të goditur përdor edhe dialektet të hapësirës shqiptare duke u dhënë edhe më shumë hijeshi episodeve dhe tipizimit të personazheve.

Myzafer R. Berberi shquhet për një stil krijues të këndshëm, tërheqës, të lirë dhe të rrjedhshëm, që ngjason me dallgët e oqeanit në vazhdimësi, që të mbajnë gjithnjë me vete, me ëndje dhe të mbërthyer në kërshtërë e mëtejshme.

Në këtë libër, nëpërmjet figuracionit letrar, autori përshfaq një filozofi të re ndaj një të vërtete biologjike e sociale të femrës, veçanërisht ky problem haset i mprehtë në kohën e sotme. Me inteligjencë të veçantë dhe objektiviteti autorit godet frikën apo hezitimin për të vlerësuar gjendjen shpirtërore, mendore e sociale të femrës, realisht ashtu siç ka ardhur ajo biologjikisht dhe historikisht në kohën e sotme. Për

mendimin tim ky subjekt kërkon lexues të zgjedhur, ndonëse pothuaj të gjithë krijimtaria e Myzafer R. Berberit i përket më shumë lexuesit të zgjedhur, sepse vetë autori ka motivin se lexuesit duhet të përshatet me nivelin e krijuesit dhe jo që ky i fundit të bjerë në nivelin e tij. E shpreh këtë mendim sepse ndoshta jo e gjithë shoqëria shqiptare është e aftë për të kuptuar këtë filozofi në mënyrë erudite me vetë realitetin historik, me shembuj të shumtë, një realitet të cilin njerëzit janë të detyruar ta pranojnë në heshtje. A mos ndoshta kemi të bëjmë me një "hop" filozofik të autorit?

Myzafer R. Berberi është ndër të parët, në mos i pari që sjell vlerat e një psikologjie të re në letërsinë shqipe, që ngjason me shkrimtarin gjerman Heinrich Eilhelm von Kleist, jo vetëm si pionier i kësaj prurjeje, por edhe me elokuencën, ndjesitë, ëndrrat apo vegimet që të duket si një realitet objektiv tek tregimet "Pendesë e vonuar", "Vrasja e bukurisë", "Shpërthim i vonshëm" etj.

Në përplasjen midis teorisë së Frojdit (Sigmund Freud, 1856-1939) mbi interpretimin e ëndrrave si një gjendje biologjike e fshehtë në neuronet e trurit ndaj teorisë moderne që i shpjegon ato si manifestim biologjik të rastësisë (kuturisjes) gjatë gjendjeve të veçanta, Myzafer R. Berberi i qëndron linjës shkencore të Frojdit për ekzistencën e tyre në gjendje të fshehtë (pra që ekzistojnë realisht në neuronet e trurit) dhe që e shoqërojnë njeriun gjatë gjithë jetës së tij. Të tilla qëndrime mban shkrimtari Myzafer R. Berberi edhe për fenomenet e ndijimit duke i vlerësuar ato si forma apo dukuri të materies. Këto pikëpamje filozofike i shfaq autorin në këtë libër nëpërmjet figuracioneve letrare (subjekteve, episodeve, personazheve), të shprehura me tregimet: "Të vërtetat e ëndrrës", "Shpërthim i vonshëm", "Femrat e arkës xy" etj.

Edhe vetë Frojdi i kundërshtonte shpjegimet psikanaliteti në veprat komplekse të artit, të cilat i shmangeshin thelbit shkencor të filozofisë së tij, siç bëjnë neofrojdistët e udhëhequr nga psikanalista gjermane Karen Horney (1885-1952)

dhe psikanalisti amerikan Harry Stack Sullivan (1892-1949), përkundrazi Myzafer R. Berberi i qëndron besnik thelbit të teorisë së Frojdit në ligjshmërinë biologjike të zhvillimit psikologjik dhe dukurve normale të jetës së njeriut, nga e cila sikurse dhe vetë Frojdi, autori përjashton dhe ndëshkon veset (per-verset) të cilat nuk mund të mbarohen në këtë ligjshmëri filogjenetike të njeriut, pra vetë natyra i pas-tron, i hedh tutje nga vetvetja dhe autori me të drejtë i vlerëson këto vese si hedhurina apo pëgërje e natyrës.

Prurja e kësaj filozofie në letërsinë shqipe nga shkrimtari Myzafer R. Berberi është një vlerë e re e çmuar që mban origjinalitetin e tij.

Në krijimtarinë e tij, autori i këtij libri, qartëson dallimin midis ndjesimeve normale biologjike dhe psikologjikisht të ligjshme ndaj deviacioneve jonormale, delireve me vese të papranueshme në shoqërinë e njeriut si shembull tregimi: "Budja me Maçu Picunë" etj. Pra, autori përball virtytin me vesin, të mirën ndaj së keqes, tregon të vërtetën lakurike të "moralit" të stisur, dhe kështu nëpërmjet veprës letrare jep mesazhe me vlera edukative.

Qëndrimi i autorit është i dukshëm dhe i shqetësuar ndaj fenomeneve të degradimit që i shfaqen në shoqërinë tonë si pasojë e veprimtari të bandave politike në vitet 1990-2000 të molepsura me gjithfarë të këqijash, që u bënë dhe bëhen shkak për viktima, ndonjëherë edhe këto shndërrohen në djaj aktivë. E tillë është "Danaida", personazhi i novelës me të njëjtin emër, ajo është një vajzë e thjeshtë, e varfër me shëndet të dobët rritur në një familje plot halle, e mbytur nga njeriimi, ajo shndërrohet në një femër djallëzore, në një vrasëse seriale që na kujton kriminelet e famshme amerikane Lizzie Andree Borden (1860-1927) dhe Aileen Euarinos (1956). Danaida, një figurë kontradiktore në jetën e saj, e cila e lufton të keqen me të keqen është kthyer në një kriminele. Megjithatë, autori si altruist që është, nuk i heq asaj nga shpirti atë që i ka mbetur ende, grimcën elementare njerëzore, dashurinë për nënën. Ky është një personazh i skallitur me mjeshtëri artistike nga autori që mbetet i ngulitur në kujtesën e lexuesit.

Në këtë libër, me tregime dhe novela, Myzafer R. Berberi ka realizuar në mënyrë cilësore futjen e një filozofie të re, të botëkuptimit psikologjik në letërsinë shqipe, duke merituar vlerat e veçanta, si një nga krijuesit më të rrallë në Shqipëri dhe natyrisht si një hap të ri që hidhet duhet guxim dhe kulturë e durim duke u futur nëpër të vërtetat e jetës. Duke e parë nga ky këndvështrim autori merr vlerë të vërteta të cilat e shquajnë si një nga prozatorët më të mirë në letërsinë shqipe.

Tiranë, 10 dhjetor 2016



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri ishte e zakonshme, por duhet të vlerësojmë epistolarin e këndshëm që patëm falë bashkëpunimit me të bijën e profesor Budës. Ajo i kushtojë marrëdhënies përmes letrave të dy njerëzve të shquar të letrave shqipe: profesor Ale-

ks Budës dhe mikut të tij, letrarit të njohur Mitrus Kuteli. Finesa, respekti për vendin, mirësjellja ishte bazë e kësaj marrëdhënie të bukur. Mbi të gjitha të mbetet në mendje finesa e artikullimit të argumenteve të kohës mes tyre. "Kujto kur unë fare e re, së bashku me tim atë, Aleks Budën, jam ndodhur në një takim në rrugë me shokun e tij të hershëm, Dhimitrin, pasi kishte dalë nga burgu. Dhimitri tregoi për shqetësimet e tij shëndetësore, sidomos për zemrën që e kishte të cililitur, duke nxjerrë nga xhepi i vogël të xhakëtës dy trinitrina që i mbante vazhdimisht me vete. Por më shqetësuese se kjo gjendje e shëndetit të përkeqësuar ishin shqetësimet për dorëshkrimet që i mungonin. Nëse nuk gaboj bëhej fjalë për rreth 200 faqe të sekuestruara nga një hetues, person me gradë ushtarake, që ishte marrë me çështjen e tij në paraburgim. Ishin dorëshkrime që duheshin gjetur dhe që s'u gjetën më. Ata kishin dalë nga Ministria e

Brendshme", kujton Tatjana Haxhimihali, e bija e profesor Budës. Redaktori shkroi diçka lidhur me "Numrin zero" të estetit të njohur italian, që e përzien natyrshëm sarkazmën, stigmnën dhe paradoksin, elementë që janë kaq të zakonshëm në veprën e Ecco-s me një ligjërim gati linear. Por ne duhet të bëjmë atë që bën një lexues për të perceptuar atë ku imagjinata shkon me të vërtetën dhe autori të shoqëron edhe vetë që ti ta kujtosh sa më mirë, shtoi redaktori. "Asgjë nuk mund të jetë e tronditë më në këtë vend. Në fund të fundit, kemi parë pushtimet barbare, grabitjen e Romës, masakrën e Seniglias", e mbyll ai...Redaktori kish premtuar ta sillte kohë më parë, por nuk kish mundur. Kujtim Morina na kishte sjellë përkthimin e dy tregimeve të një autore të njohur nga Kuvajti. Një lloj rëfimi që nuk mund të thuhet se është një rëfimi me parametra shumë të lartë por që falë kujdesit të përkthyesit na kish sjellë autorin Haifaal

Sanousi me shumë respekt dhe cilësisht. Kjo sepse ti më shumë sesa propagandë e ditës kupton funksionimin e brendshëm të këtyre vendeve. Në këtë numër përcollim dhe botimin e dy autorëve shqiptarëve në botë, Arian Leka në Gjermani dhe Bashkim Shehu në Spanjë. Shkrimtari shqiptar Arian Leka botohet në Berlin. Ky botim i fundit u publikua falë përzgjedhjes dhe kujdesit të dy emrave të njohur për letërsinë në atë vend: të shkrimtarit, poetit e përkthyesit gjerman Michael Krüger, i cili është dhe gjithashtu edhe President i Akademisë Bavarëze të Arteve të Bukura si dhe të shkrimtares, përkthyeses dhe kritikes letrare gjermano-kroate Alida Bremer. Kur për Bashkimin kishim marrë romanin "Angelus Novus" (Botimet Toena, 2005) që sapo qarkulloi në spanjisht nga Shtëpia Botuese Siruela, një nga më të preziozitetet e këtij vendi, me përkthim të Mar-

Roces González dhe parathënie të Bernardi Atxaga. "Angelus Novus", sjellë nga "TOENA" ka qenë më parë finalist në konkurrimin për gminin "Balkanika 2007" dhe një prej rrrëfimeve të përfshirë në të është botuar edhe si libër më vete në Francë me titullin "Gracka". Shkrimtarija, pjesëmarrëse në Rezidencën letrare "POETIKA - Tirana in Betëen" - gjatë muajit Maj 2017 ishte regjimatrja dhe kritikja letrare nga Beograd, Jasna Dimitrijevic. Gjatë qëndrimit të saj në Tiranë Jasna Dimitrijevic u përfshi në veprimtari dhe lexime publike, dhe intervista për mediet dhe u bë pjesë e takimeve me studentët të Universitetit, por edhe i morën një pjesë nga krijimtaria e saj, falë një përkthimi të bërë nga një koleg kosovar. Redaktori mendon se numri ishte i mirë dhe i paqitë, kurse grafika mund të ishte pak më eksperimentuese, paqka se vetë redaktori u duk i fjetur në prozozimet në këtë numër.

Vijon nga faqja 19

NGA DASA DRNDIC\*

pesë gjuhë. Me frymën e tyre të vdeqes ata thërrasin Mutti, mama! mamma mia, oh mamma!majko! anyuka, anyuka! mamusi! maminka! Zogjite nuk do fluturojnë. Zogjite do bien. Shiu i zi i zogjve do të bëhet qefini i vdekjes për Soëa-n. Franz Ferdinandi i ndjekur prej anëtarëve të familjes së tij, zbrit nga treni, u jep dorën ndërtesuesve, ia bën me dorë gjindjes, qesh, e atëherë i afrohet parmacut të urës së mrekullueshme të bardhë, ndërtaur me 4533 blloqe guri gëlqeror dhe këqyr nga lumi që shkëlqon. Arkitekti Rudolf Jausne dhe inxhinieri Leopold Orley nuk e fshehin nderin dhe gazminin. Franz Ferdinandi shikon nga lumi Soëa/Isonzo dhe nuk ia ka idenë sesa premtime dashurie dhe premtime pasionante janë hedhur në ujërat e tij, teksa është ngritur zemërueshëm, ka përmbytur brigjet e veta, i pafuqishëm të ndalojë sulmet në qiellin e vet. Jausner-it dhe Orley-it iu është dashur gati dy vjet ta bëjnë të flasë mrekullinë e tyre: ura më e madhe e harkuar hekurudhore, ngritur rralëherë mbi ndonjë lum. Në urë janë ngritur pesë mijë ton gurë; harku i mesëm, që ka përfunduar për vetëm tetëmbëdhjetë ditë, ka hapësirë prej tetëdhjetë e pesë metra, një masë e paparë deri më atëherë.

Dhe, kështu ndodh që është përuar linja e famshme hekurudhore "Transalpina": një udhë që do të lidhë bregdetin, aktualisht Triestën me linjë direkte me Austrinë. Monarkia kish nevojë për lidhje direkte me provincat e veta më në Jug, Monarkia nuk dëshironte të udhëtonte përmes territoreve të huaja, të tilla si përmes Udines. Monarkia me vete ishte e kënaqur përdërisa tokat që i takonin filluan të dukeshin të papëlqyeshme kështu që do të qonja; derisa i humbi edhe ato që kish. Sot në Gorizia, përmes linjës kryesore hekurudhore kalon linja "Meridionale", e ndërtaur në gjysmën e dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Trenat që duhet të ndalojnë në Gorizia janë gjysmë të zbrazur. Sikur Gorizia është ende duke shëruar plagët e luftës. Gorizia e re mbetet në "Transalpina". Në kufirin në mes të Goricës së re dhe Gorizian ndodhet muzeu në të cilin ruhen disa sende të vjetra pa emër. Në "kufirin e fortë" të dikurshëm në të cilin ndodhet Gorizia, që e ndan si kullaç, në dy pjesë jo të rregullta, mbi atë "kufij të fortë" sot ndodhet një shesh në të cilin mund të shëtitin të gjithë. Përtej sheshit, në të dy gjysmat e qytetit të ndarë, ende qën-

dron si gjithmonë një si mur ajror. Lartësi të tyre Franz Ferdinandi dhe Dukeshja nga Hohenberg-u Sophie Chotek, herën e fundit kaluan përmes urës së Solkan-it mbremjen e së martës më 23 qershor 1914. Çifti martesor iu ngjiten "Transalpinës" në Vjenë që do t'i conte drejt Triestes. Dritaret e kupesë së tyre janë të hapura. Qershori kundërmor erën e pemëve të blirit. Sophia këndon nën zë Në t'bukurin Danub të kaltër, dhe Franz e pyet: Ndoshta edhe këtij lumi të vogël do t'i këndojnë këngë? Sofia i thotë: Nuk e besoj. Ky është një lum i vogël, i parëndësishëm dhe i panjohur. Franz i thotë: Ndoshta nuk do të jetë gjithnjë kështu. Sophie dhe Franz ngrënë doli për njëri-tjetrin me një gotë verë të ftohtë Tokay të klazit të parë. Ata këtë nuk e dinë, por zemra e tyre pulson ashtu si rrjedh atë cast Soça në urën Solkan.

Të mërkurën e 24 Qershorit

isha më i aftë ta mbartja". Në korrik 1914 Franz Ferdinand dhe Sofia udhëtonin me të njëjtën anije luftarake austro-hungareze "Viribus unitis", e cila kishte ardhur këtë herë ngarkuar me arkivolë. Në shtator 1914, shefi i përgjithshëm rus botoi



një "Hartë të Evropës së ardhme" që ka një ngjashmëri mahnitëse me atë që do të bëhet më 1945. Plumbi me të cilën Principi goditi Ferdinantin ruhet në Konopistë. Është njëzetë e pesë maji i vitit 1915. Përmes Urës së Solkan-it kalonte treni i fundit i udhëtarëve nga Vjena për në Trieste. E shkatërruar, bombarduar, e riparuar dhe sërish e goditur me një barazh zjarri, e gjitha vazhdoi deri më 1918. Ura e Solkan-it pëshkollti bateritë, ka mbledhur kolonat e ushtarëve të konfliktit të ushtarëve austriakë, austriako-gjerman dhe italianë. Marshonte edhe Bruno Baar.

Bruno Baar atë kohë ishte dyzetë e nëntë vjeç. Kishte bark, tre fëmijë dhe gruan që piqte kullaç për ushtrinë austriake. Kishte një punishtë vere, në të cilën nuk bëhej më verë. Kishte një koleksion më pllakat më të fundit të gramafonit të viteve '70-'80, që për momentin nuk mund t'i dëgjonte kështu që i mbetjet thjesht të ëndërronte për to teksa marshonte përgjatë brigjeve të përmbytura të Soëa-s, duke kënduar nën zë La donna e mobile sepse e adhuronte Caruzon. Ndërkohë Marisa e tij, tundej duke ngulur takat e saj të larta, teksa çonte kifili arrasth në bordel për oficerët austro-hungarezë, me mendimin se ajo ishte Bice Adami, që detyronte publikun milanëz t'i cohej në këmbë teksa e shoqëruar nga klaviri ajo po interperonte Voi lo sapete. Duhanit i vet i keq ia kish ashpërsuar zërin

Marisa Baar-it, me emrin e lindjes Brausië, orvatut të bëhej soprano, por pa mundur dot. Një pikël shiu vere i bie asaj në qepalla, ku mbetet, duke bërë një top kristali në miniaturë në të cilën gjendet e shkruar e ardhmja e saj. Këndon Marisa Baar Voi lo sapete duke mos dyshuar as edhe një çikëz që Bice Adam do mbijetojë në fakt më gjatë se ajo. Cadorna e fillon betejën me një zjarr artilerie diversioniste më 6 Gusht të vitit 1916. Në jug para Monfalkones, ai vendosi dy njësi këmbësorie me dy korpuse si karmen. Hileja e Cadornit nuk ia doli. Njësjë austriake nuk lëvizti nga vendi. Konti Franz Conrad von Hötzendorf, ashtu si ishte, kish prerë pas murin e trupave përgjatë frontit në Soëa me qëllimin të mbështeste ofensivën e tij afër mbi Trentino. Ndërsa Cadorna që aty (me linjën Transalpine) shpejt i zhvendosi trupat e veta nga Tren-

por krejt e asimiluar hebreje, jo si nëna e Haya, Ada, që vjen nga familje e varfër por edhe një familje hebreje krejt e paasimiluar. Mes paraardhësve të Florianit ka studiues të Talmudit, financierë, kimistë, xham-punues, skulptorë, studentë të dështuar, muzikantë, detarë, koleksionistë, antifashistë dhe fashistë. Disa prej tyre gjenden në varreza kudo nëpër Itali, varreza katolike, varreza hebrejsh, ndërsa kockat e të tjerëve janë humbur në re që kërcëjnë, duke lëshuar topha të zezë ngarkuar me pluhurin gri, të mrekullueshëm si Staubzucker i pistë (sheqer i ashpër pasticierie). Disa janë këtu në Gorizia, jo në Gorizia, sesa atje në Gorica, në një breg që s'është shumë si breg, në një breg që nënkupton të jetë e gjitha me trëndafila dhe Haya Tedeschi nuk kujton ndonjë trëndafil në këtë breg, pasi s'ka asnjë të vdekur nga të vetët këtu, sepse e ëma i tha asaj, makar ishte në ëndërr por i kërkoi asaj, ta varrosë në Bregun e Trëndafillave në Valdisirose, sepse Haya e vendosi gabimisht nënën e saj Ada në vdekje, ashtu si humbi dhe gjyshen Marisa që asnjëherë nuk e kish njohur, po çfarë tjetër mund të bënte, ajo ishte e re dhe përreth zhvillohej luftë veç kësaj ishte një varreze hebrejsh me shumë gurë të ngritur vertikale, tani të vjetër dhe të pjerrët, brengosur nën myshkun e lagësht si gjymtyrë? të amputuara të një trup prej kohësh të vdekur. Dhe të sajat, të Haya-s, nga ana e babait të vet prej njëqind vjetësh apo më shumë, nuk preheshin në të tilla varreza të hebrejve. Në Gorica, pjesën e re, Haya Tedeschi e di mirë, prehet njëfarë Wilhelm Tedeschi, i rënë në vitin 1891, i lindur në Mannheim më 1837, skulptori që kish dhënë mësimë pikture në Piran, në Trieste dhe më vonë në Gorizia, po në Gorizia dhe para kësaj në Pulie, ku edhe sot mund të qëndronte busti i admiralit Bourguignona, realizuar prej tij. Në atë familje të Hayas nga ana e Florianit, falë Zotit, kishte muzikantë dhe bërës-rratash, që krijojnë kompozime për disa lloje dëgjimi dhe parjeje që me sa duket shprehin bukurinë që Haya megjithatë nuk e kupton fare. Dhe atyre me sa duket kompozitorëve dhe rotëbërësve u kanë humbur gjurmët. Sepse, ndërsa ajo pret në një ndërtesë të vjetër në Via Aprica 47, ndërsa shkartin kartat e të gjitha këtyre jetëve, jetë që rreshtëq nëpër gishtave të saj, sikur po luan pasijën (spathi), Haya gjithnjë e më shumë tund kokën dhe thotë Ne jemi familje pa gjurmë. ...Më 30 tetor fashizmi edhe zyrtarisht ulet në fron...

# Haya Tedeschi

Si scopron le tombe, si levano i martiri nostri son tutti risorti! Le spade nel pugno, gli allori alle chiome, La fiamma ed il nome d'Italia nel core; Corriamo, corriamo! Sù giovani schiere, sù al vento per tutte le nostre bandiere Sù tutti col ferro, sù tutti col foco, Sù tutti col nome d'Italia nel cor. Va' fuori d'Italia, va' fuori ch'e l'ora! Va' fuori d'Italia, Va' fuori o stranier! Populli më pas do këndojnë këngë të tjera. Më së shumti do këndojnë gratë, e më së shumti do këndojnë një këngë me refrenin O, Gorizia, tu sei maledetta. \*\*\* Babai i Haya, Florian Tedeschi rrjedh nga një familje pasunare,

\*Përkthet nga origjinali Ben Andoni